



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

V.KA.Nr. 4-13/22
Prishtinë, 26.08.2022

KOMISIONI I ANKESAVE I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në përbërje nga Av. Agim Shala - Kryetar, Av. Kadri Sylaj dhe Av. Shpetim Sadiku – anëtarë, me pjesëmarrjen e Ma.sc. Vjollca Ajeti në cilësinë e procesmbajtëses, duke vendosur lidhur me ankesën e protokoluar me nr. 4-11/22 të dt.11.08.2022, e parashtruar nga e autorizuar e të paraqiturit Av. nga Av., kunder vendimit të Komisionit Disiplinor të Odës së Avokatëve të Kosovës me nr. V.KD.Nr.4-10/2022 të datës 15.07.2022, në seancën jo publike të mbajtur me datën 26.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** ankesa e ushtruar nga e autorizuar e të paraqiturit Av. me seli te zyres në Istog, si e bazuar, dhe
- II. NDRYSHOHET** vendimi i Kolegjit Disiplinor V.KD.nr.4-10/2022 i dt.15.07.2022.
- III. HUDHET** propozimi i Prokurorit Disiplinor i OAK-së me nr. 55-3/2020 i dt.18.02.2022, për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të ndjekjes disiplinore.
- IV. Shpenzimet** e procedurës bien në barrë të buxhetit të OAK-së

A r s y e t i m

ZPD e OAK-së me propozimin nr.55-3/2020 të dt. 18.02.2022, ka bërë propozim që të zhvillohet procedura sinas fletë-paraqitjes nr.55/20 e ushtruar nga Z. NGA Fsh. K. e kunder Av. nga Istogu me nr. te licences dt.26.07.2013, me adresë si ne propozim,dhe ti shqipto. t masa disiplinore për shkak të shkeljeve të rënda nga neni 118 par.1.3 dhe 1.7 të Statutit të OAK, lidhur me nenet 71,72, 44 të KEPA-së. Sepse i parqituri nuk ia ka kthyer parat e pëerfaqesimit klientit, te cilat shpenzime ia kishte pranuar gjykata pales. Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës në seancën e mbajtur me datën 15.07.2022 në rishqyrtimin e kesaj çeshtje disiplinore, pasi e rishqyrtoi raportin e Prokurorit Disiplinor të OAK-së dhe shkresat e tjera të lëndës, mori vendim që të aprovohet propozimi i Prokurorit Disiplinor të OAK-së dhe të zhvillohet procedura disiplinore ndaj av. nga

Komisioni disiplinor i OAK-së ka caktuar seancen e rishqyrtimit kryesorë per dt.15.07.2022 ne te cilen seancë kanë marr pjesë Prokurori disiplinor i demtuari i paraqituri Av. dhe e autorizuar e të paraqiturit Av. nga Komisioni disiplinor ka zhvilluar ecurin e procedures ashtu siq e parashofin dispozitat ligjore dhe aktet normative te

OAK-së. Pastaj ka administruar serish provat e propozuara nga palet ne procedurë dhe e ka proceduar edhe te paraqiturin, duke i pytur palet nese kan propozime edhe për ndonji provë tjeter, e meqe nuk ka patur propozime per ndonji provë te re.Pas perfundimit te proqesit disciplinor dhe pas paraqitjes së fjales përfundimtare, komisioni disciplinor merr vendim me të cilin te paraqiturin e shpallë pergjegjës dhe të njejtit ia shqipton denimin me gjobë prej 700,00 euro duke e detyruar edhe ne kompenzimin e paushallit diciplinor në lartësi prej 50,00 euro.

Komisioni i Ankesave i Odës së Avokatëve të Kosovës në seancën jo publike të mbajtur me datë 26.08.2022, pas referimit të rastit, shikimit të shkresave të lëndës dhe egzaminimit te ankeses të ushtruar nga e autorizuar e te paraqiturit, e aprovoi ankesen e te autorizuares se të paraqiturit Av. nga Prishtina , si te bazuar.

Komisioni i Ankesave i OAK -së ne cilësin e organit të shkalles së dytë, sipas autorizimeve te parapara me nenin 110 pika 1 dhe 111 pika 1 te Statutit të OAK – së, pas shqyrtimit te shkresave të lëndës dhe të ankese seë te autorizuares së të paraqituri Av. , konstatoi se ka ardh deri të parashkrimi absolut i kesaj çështje disciplinore. Pra kjo çështje discilnore , konform nenit 56 al.2 të Ligjit për Avokatin, nga se kan kaluar me shumë se dy viteprej dites se kur është kryer shkelja nga ana e të paraqiturit Av. nga

Nji konstatim te tillë Komisioni i Ankesave e mbeshteti në faktin e vertetuar se fletëparaqitja nr. 55/20, e parashtruan nga është parashtrua me dt.23.07.2020 n.dersa shkelja nga ana e të paraqiturit është berë edhe ma heret, se sa data kur është parashtru fletëparaqitja,

Duke patur parasy faktet e parshtruara më lartë,Komisioni i Ankesave i Odës së Avokatëve të Kosovës, konform nenit 47, të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI I ANKESAVE I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS
Prishtinë, V.KA.nr. 4-13/22 të datës 26.08.2022

Kryetar i Komisionit të Ankesave,
Av. Agim Shala

